

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900095/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: Rekomandim për garantimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar në Qendrën e Zhvillimit "Lira", Berat.

KRYETARIT TË BASHKISË SË BERATIT

ZOTIT PETRIT SINAJ

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

ZONJËS MERITA XHAFAJ

ZYRËS RAJONALE TË PUNËSIMIT

TIRANË

DREJTORIT TË QENDRËS SË ZHVILLIMIT "LIRA"

ZOTIT ARMAND AGALLIU

BERAT

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, në mbështetje të Kushtetutës, ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, si dhe të urdhrorit nr.327, datë 6.9.2018, të Avokatit të Popullit "Për inspektimin e institucioneve të përkujdesit social, rezidencial dhe ditor, që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë", realizoi në datën 22.10.2018, inspektimin në Qendrën e Zhvillimit "Lira", Berat.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi dhe inspektimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'Ju parashtrojë përfundimet e tij, si më poshtë vijon:

Objektivat e inspektimit:

- kontrolli i performancës në institucionet, që ofrojnë shërbime të përkujdesit social për fëmijët me aftësi të kufizuar, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe procedurave;
- vlerësimi i cilësisë së punës së personelit të institucioneve të përkujdesit social;
- vlerësimi i mjediseve dhe kushteve të insitucionit;
- vlerësimi social-psikologjik-shëndetësor i çdo përfituesi në institucionet e përkujdesit social;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve, në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar në fuqi.

Metodologjia

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga një jurist dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

Së pari, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin e këtij institucioni, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.

Së dyti, zhvillimin e intervistave me punonjësit dhe përfituesit e institucionit, për cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Së treti, monitorimin e nivelit të zbatimit të paketës së akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi në kontekstin e respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Së katërti, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të Qendrës së Zhvillimit, ku ofrohen shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe me probleme të shëndetit mendor.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit ka zhvilluar bisedën përmyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, bazuar në konkluzionet e inspektimit të ushtruar në Qendrën e Zhvillimit "Lira", në të gjithë institucionin, intervistave të zhvilluara me punonjës social, kujdestarët dhe përfituesit e shërbimeve, si dhe vëzhgimeve të kryera, për të provuar cilësinë e

shërbimit që i ofrohet fëmijës, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit, si edhe rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuara në fund të këtij raporti.

Më lejoni, t'Ju parashtroj ndërtimin strukturor dhe profilin e Qendrës së Zhvillimit “Lira”, si vijon:

Qendra e zhvillimit “Lira” Berat

Qendra e Zhvillimit “Lira” Berat, është një ndër institucionet publike, në varësi administrative të Bashkisë Berat, që ofron shërbime rezidenciale dhe ditore për fëmijë, të rinj dhe adultë me aftësi të kufizuar, të ardhur nga familje me probleme të vështira social-ekonomike.

Ky institucion nuk është i licensuar në mbështetje të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si rrjedhojë e problematikës të mbartur ndër vite, atë të mungesës së certifikatës së pronësisë.

Funksionimi dhe organizimi i qendrës realizohet në mbështetje të deklaratës së qëllimit nr.2/1, datë 4.1.2017, miratuar nga drejtuesi i institucionit.

Deklarata e qëllimit¹ përcakton qëllimin, objektivat dhe shërbimet, që ofrohen nga ky institucion, ku janë të përfshira veprimtaritë përkatëse për çdo shërbim, vlerat e qendrës, struktura organike, të dhënat për personelin si dhe procedurat e shërbimeve.

Qendra e Zhvillimit “Lira” Berat, ofron shërbime të përkujdesit social rezidencial dhe ditor, për personat me aftësi të kufizuar prej 10 vjetësh. Numri i përfituesve rezidencialë në këtë institucion, gjatë kryerjes së inspektimit, është 16, ku dy prej tyre janë minorenë, njëri 13 vjeç dhe tjetri 16 vjeç.

Ndërsa, numri i përfituesve ditorë ishte rreth 30, ku 9 përfitues janë adultë, të cilët marrin shërbimin e fizioterapisë dhe 23 fëmijë të grupmoshës 3-12 vjeç.

Tipologjitë e shërbimit në këtë institucion, të parashikuara në deklaratën e qëllimit, janë si vijon:

- shërbim rezidencial, kapaciteti për 16 përfitues;

¹ Kriter i përcaktuar në standartin 1, vendimit nr.822, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave “Për standardet e përkujdesit shoqëror, personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale” dhe udhëzimi Nr.1730, datë 27.09.2010, të ministrit të Mbrojtjes Sociale dhe Shansëve të Barabarta. “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore”.

- shërbim ditor, kapaciteti për 30 fëmijë/të rinj dhe adultë.

Mbështetur në tipologjitë e shërbimeve të ofruara në këtë qendër, llojet e shërbimeve sociale të ofruara për çdo tipologji shërbimi përshkruhen më poshtë.

Shërbimi rezidencial ofrohet nga një ekip multidisiplinar dhe ka si qëllim ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente apo kronike, integrimin social, rehabilitimin psikosocial dhe riaftësimin social e profesional pa medikamente mjekësore, bazuar në llojet e shërbimeve si vijon:

- akomodim dhe ushqim;
- shërbim shëndetësor në bashkëpunim me shërbimet publike mjekësore;
- aktivitete social-kulturore brenda dhe jashtë qendrës;
- mbështetje dhe ndihmë për përfituesit dhe këshillim për familjet e tyre;
- edukim dhe rehabilitim;
- ndërhyrje dhe mbështetje, për kryerjen e aktiviteteve ditore në atelietë përkatëse, për të përfituar autonomi individuale, për aktivitetet e përditëshme dhe integrim.

Pjesëmarrja e përfituesve në këto veprimtari ditore, në atelietë përkatëse, ndihmon në zhvillimin e pavarësisë praktike dhe autonomisë, menaxhimit të kohës, nëpërmjet punës në atelie dhe mirëmbajtjes së shtëpisë, si dhe minimizimi i krizave, duke qenë të angazhuar me punë, pa medikamente mjekësore.

Shërbimi ditor në institucion ofrohet nga specialistë të disiplinave të ndryshme, të cilët kryejnë veprimtari parandaluese, këshilluese, rehabilituese për fëmijët, të rinjtë dhe adultët, bazuar në llojet e shërbimeve, si vijon:

- transporti i përfituesve falas, të shoqëruar me personel, nga shtëpitë e tyre në qendër dhe anasjelltas;
- 2 vakte ushqimore (mëngjes + drekë);
- fizioterapi (terapi individuale në zhvillimin e psikomotricitetit);
- logopedi (terapi individuale në zhvillimin e komunikimit);
- terapi zhvillimi;
- shërbime kreative-kulturore dhe bashkëpunimi;
- shërbime psiko-sociale (vlerësimi i nevojave dhe terapi grupi);
- shërbime terapeutike-edukative, për të garantuar ruajtjen dhe rritjen e aftësisë fizike, sociale dhe pavarësinë individuale;
- aktivitetet sociale-kulturore brenda dhe jashtë qendrës.

Nisma për vendosjen e 12 përfituesve në këtë qendër është ndërmarrë në kuadër të procesit të de-institucionalizimit. Personat me aftësi të kufizuar, defiçite mendore apo fizike, jo të rënduar, u transferuan nga Qendra e Zhvillimit Berat, me qëllim integrimin e tyre për një jetesë të pavaruar nëpërmjet formëzimit të kësaj tipologjie të re shërbimi.

Përfituesit rezidencialë të këtij institucioni janë akomoduar në këtë shërbim, me vendim të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Ndërsa, vendimi për sistemimin dhe akomodimin e personave më aftësi të kufizuar në këtë institucion, është kompetencë e Këshillit Bashkiak të qytetit të Beratit.

Struktura e institucionit është miratuar me vendimin nr. 846, datë 29.12.2017, të kryetarit të Bashkisë Berat. Ajo përbëhet nga 22 punonjës, të kategorizuar në pozicionet e punës si më poshtë vijon:

- një drejtor;
- sektori i shërbimit social;
- një përgjegjes sektori social (pedagogji e specializuar sociale);
- dy specialistë (fizioterapist);
- një specialist (logopedist);
- shtatë specialistë (arsimi i lartë, profili edukator);
- një infermier i lartë;
- tre edukatorë/kujdestarë (arsimi i mesëm);
- sektori i administratës;
- një përgjegjes i sektori të financës;
- një kuzhinier;
- një punëtor mirëmbajtës/shofer;
- një roje nate;
- dy pastrues.

Nga intervista e realizuar, ndërmjet drejtuesit të qendrës dhe stafit të institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me numrin e personelit, (dokumentuar në procesverbalin përkatës), është konfirmuar numri 22 punonjës. Por, nga vlerësimi dhe kontrolli i dokumentacionit, vendimit nr. 846, datë 29.12.2017, të kryetarit të Bashkisë Berat dhe deklaratës së qëllimit nr.2/1, datë 4.1.2017, miratuar nga drejtuesi i institucionit vërehet, se ka një mospërputhje të numrit të punonjësve. Konkretisht, në vendimin nr. 846, datë 29.12.2017, të kryetarit të Bashkisë Berat, numri i punonjësve në total është 22 punonjës, ndërsa në deklaratën e qëllimit, nr.2/1, datë 4.1.2017, numri i tyre është 18 punonjës.

Për sa më sipër, si dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi², deklarata e qëllimit është një dokument i rëndësishëm, që ndihmon personelin dhe profesionistët të vlerësojnë nevojat minimale të PAK dhe sistemimin e tyre në institucion, informon stafin, PAK dhe familjarët e tij për strukturën e qendrës dhe shërbimet që ofrohen, ndihmon drejtuesin në menaxhimin, si dhe në vendimarrjen për sistemimin e PAK në institucion.

Në këtë kontekst, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson rritjen e numrit të punonjësve në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në këtë qendër me vendim të këshillit bashkiak. Deklarata e qëllimit duhet të pasqyrojë edhe ndryshimet e ndodhura në kohë, konkretisht shtesat ose pakësimin në numrin e personelit të qendrës duke e ekspozuar në një vend të dukshëm për PAK, familjarët, vizitorët, inspektorët e shërbimeve si dhe vetë personelin etj.

Vlerësimi sasior dhe dinamika e lëvizjes së përfituesëve të qendrës

Kapaciteti i qendrës është për 40 përfitues rezidencialë dhe ditorë së bashku. Ndërkohë, gjatë kryerjes së inspektimit, qendra ofronte shërbime rezidenciale dhe ditore për 36 përfitues.

Konkretisht, qendra ofron shërbime të përkujdesit shoqëror për 16 përfitues rezidencialë, ku vetëm dy prej tyre janë minorenë, përkatësisht 13 dhe 16 vjeç. Ndërsa, përfituesit ditorë janë 23 fëmijë të moshës, nga 3-12 vjeç. Nga numri total i përfituesve 19 janë femra dhe 17 meshkuj. Nga vlerësimi i diagnozës, 3 përfitues janë me paaftësi fizike dhe 33, janë me paaftësi mendore. Nga numri total i tyre, 29 përfitues marrin zhvillim dhe, shtatë prej tyre jo. Nga 16 përfitues rezidencialë, tetë prej tyre janë pa interesim nga familja.

Për sa më sipër, dinamika e lëvizjes së përfituesëve rezidencial nuk ka ndryshuar që në momentin e krijimit të qendrës, ndërsa numri i përfituesëve të shërbimit ditor është më fleksibël.

Shërbimi i përkujdesit social rezidencial

Përfituesit rezidencialë janë të sistemuar në apartamente të mbrojtura, ndryshe nga institucionet e tjera të ofrimit të shërbimeve rezidenciale për PAK.

² Vendimi nr.822, datë 6.12.2006, i Këshillit të Ministrave “Për standardet e përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale” dhe udhëzimi nr. 1730, datë 27.09.2010 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore”

Këto apartamente ofrojnë organizimin e një jete familjare, përkatësisht të ndarë në dy grupe, ku secili grup është i mbikëqyrur dhe nën kujdesin e edukatorëve. Çdo anëtar grupi ka një rol të caktuar në familje, në përputhje me aftësitë e tij, p.sh., gjatë kryerjes së inspektimit, një përfitues, i cili kishte aftësi në punimet e mirëmbajtjes së shtëpisë, së bashku me një punonjës të stafit ishin duke kryer punime rikonstruksioni për eliminimin e lagështirës së tualeteve.

Gjatë intervistës së realizuar me të, ai na tregoi për shumë punë të mira që kishte kryer në të dyja apartamentet (ndrejte bravat e prishura, lavamanët e bllokuar, etj).

Jeta e organizuar në apartamentet e mbrojtura ka si qëllim nxitjen dhe krijimin e besimit tek përfituesit me aftësi të kufizuar për jetesë të pavaruar. Kjo, ju jep mundësi për të shprehur nevojat, dëshirat, si dhe marrjen e përgjegjësi për organizimin e jetesës së tyre, duke marrë role përgjegjësi në bazë të aftësive të tyre. Në këtë mënyrë, bëhet e mundur sigurimi i një mjedisi familjar, favorizon dukshëm zhvillimin e tyre, si dhe i ndihmon të integrohen nesër në jetesë të pavarur.

Gjithashtu, përveç jetës në apartamente, përfituesit rezidencial janë të përfshirë edhe në punët e ateliesë. Ky element është i rëndësishëm për pajisjen e personit me aftësi të kufizuar në vlera konkrete për integrimin e tyre social dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre fizike, psikike dhe motorike.

Qendra ofron tre atelie kreativiteti, lavanteri dhe kopshtari. Përfituesit ishin të përfshirë në këto atelie, në përputhje me pritshmëritë individuale të çdo përfituesi, në përputhje me mundësitë dhe limitet e tyre. Për çdo përfitues në shërbimin e ateliesë hartohet plani i inkuadrimit, në përbërje të të cilit janë edukatorët, prindërit, vetë përfituesit, mjeku dhe specialistët e fushës.

Shërbimi i përkujdesit social ditor

Shërbimi i përkujdesit social ditor ofrohet për fëmijë dhe adultë me aftësi të kufizuara, të cilët vijnë nga komuniteti përreth. Kapaciteti i shërbimit ditor është rreth 30 përfitues. Grupmosha e përfituesve ditorë varion, nga 3 vjeç deri në 38 vjeç. Ofrimi i shërbimeve ditore për këta përfitues është kryer në vlerësim të moshës, shkallës së aftësisë së kufizuar dhe nevojës për shërbim, në përputhje me shërbimet e specializuara dhe stafin e kualifikuar që ofron qendra.

Në këtë kuptim, përfituesit ditorë janë të organizuar në tre grupe:

- grupi i parë, kopshti për fëmijët e grupmohës, nga 3-11 vjeç;

- grupi i dytë, adoleshentë, nga mosha 14-18 vjeç;
- grupi i tretë, adultë, të grupmohës nga 18-30 vjeç, të cilët marrin shërbime mësimore edukative të reduktuara në mini atelie, si rrobaqepësi, punë dore etj.

Gjithashtu, për përfituesit e shërbimit ditor, në varësi të nevojave specifike të tyre, ofrohen shërbimet e logopedisë dhe fizioterapisë, të realizuara në përputhje me planet individuale të zhvillimit.

Për të gjithë përfituesit ofrohet një vakt ushqimor, dreka.

Për sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e bërë në këtë institucion, ku pesë fëmijë, të cilët kanë marrë shërbime të specializuara ditore në këtë qendër, tash janë integruar në shkollat publike të qytetit të Beratit.

Për vlerësimin e nevojave të përfituesve me aftësi të kufizuar të këtij institucioni, përfshihen të gjithë profesionistët, që punojë drejtpërdrejt me ta.

Ofrimi i këtyre shërbimeve është në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren e qendrës. Procedurat janë si vijon:

- procedurat e funksionimit të ekipit multidisiplinor;
- procedura e përkujdesit shëndetësor;
- procedura për arsimimin;
- procedura për zbavitjen;
- procedura e ankimimit;
- procedurat e marrjes së mendimit të fëmijëve për organizimin e jetës në shtëpi;
- procedurat e mbrojtjes nga abuzimet dhe raportimit;
- procedurat e mbrojtjes nga zjarri dhe procedurat e emergjencës;
- procedurat e mbajtjes së lidhjeve me familjarët;
- procedurat e largimit nga qendra.

Këto procedura janë të mbështetur në vendimin nr.822, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave “Për standardet e shërbimeve shoqërore, personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore”, si dhe udhëzimin të zbatim të këtij vendimi. Kujdesi në qendër mbështetet në profesionalizmin e një ekipi multidisiplinor, me qëllim maksimalizimin e potencialit të përfituesve.

Në përfundim, nga analizimi i gjetjeve, provave dhe fakteve, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson këtë tipologji shërbimi, e cila ndihmon dhe mbështet personat me aftësi të kufizuar për të qenë të pavaruar nesër në

shoqëri, por pavarësisht punës së mirë të bërë, duhet që këto rezultate të konkretizohen, nëpërmjet krijimit të kushteve, për rintegrim në jetesë të pavarur të përfitueseve të këtij shërbimi, në çastin e daljes nga qendra.

Mbështetja financiare e Qendrës së Zhvillimit “Lira”

Qendra e Zhvillimit “Lira” Berat, është institucion publik, në varësi administrative të Bashkisë Berat, e cila mbështetet nga fondet e buxhetit të shtetit.

Kjo qendër është ngritur me fondet e Kooperacionit Zviceran, përmes Shoqatës zvicerane “ASED”. Projekti për ngritjen e Qendrës “Lira” është mbështetur në ligjin nr.8777, datë 26.4.2001, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për bashkëpunimin teknik, financiar dhe asistencë humanitare”, si dhe në disa vendime në zbatim të tij. Që në hapat e para të hartimit të marrëveshjes, është përcaktuar se objekti që do të ngrihej, do të ishte pronë e Bashkisë Berat, përcaktuar kjo, edhe në aktin e dhurimit nga qeveria zviceriane.

Në praktikën e funksionimit të kësaj qendre, janë deleguar fonde nga buxheti i shtetit për këtë shërbim nga MPCSSHB. Në vazhdimësi, kjo qendër është financuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nëpërmjet transfertave për pushtetin vendor, si transfertë e pakushtëzuar për Bashkinë Berat, për çdo vit.

Më konkretisht, në përputhje me nenin 16, të ligjit nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, janë të specifikuar fondet e pakushtëzuara, që buxheti qendror ja transferon pushtetit vendor, për administrim, ku përfshihet edhe programi “Mbrojtja sociale”, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Aneksi 1 ka përcaktuar njësinë përkatëse për çdo transfertë specifike, për financimin e funksioneve të bashkisë, ku kjo njësi për programin e “Mbrojtjes Sociale” është në shumën prej 23. 496. 000 (njëzetë e tre milion e katërqind e nëntë dhjetë e gjashtë mijë lekë). Ky fond i buxhetit të shtetit përfshin fondet për paga dhe sigurimet shoqërore të personelit shërbyes dhe shpenzime operative për qendrën “Lira”, Berat.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sektori i financës, pranë kësaj qendre, lidhur me planifikimin dhe realizimin e fondeve për menaxhimin dhe administrimin e qendrës, rezultoi si më poshtë vijon:

- për vitin 2016, planifikimi i fondeve ka qenë në masën 19. 640. 000 lekë dhe realizimi në masën 17.130.000 lekë, pra afërisht rreth 87%;
- për vitin 2017, planifikimi i fondeve ka qenë në masën 23. 788.000 lekë dhe realizimi në masën 21.573.000 lekë, pra afërisht rreth 90%;

- për vitin 2018, fondi i parashikuar ka qenë 23.494.000 lekë, realizimi i fondit kur është kryer inspektimi, nuk ka qenë i mbylluar;
- për vitin 2019, mbështetur në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, fondi i parashikuar për këtë qendër, është në vlerën 23.731.000 lekë.

Nga analiza e lartpërmendur konkludojmë se fondet e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit për Bashkinë Berat, në programin “Mbrojtja sociale” për ofrimin e shërbimeve rezidenciale dhe ditore të qendrës “Lira”, nga viti 2016-2019 kanë një trend rritës, pra janë të konsiderueshme, por menaxhimi dhe administrimi i tyre nga ana e bashkisë lë për të dëshiruar, kjo e pasqyruar nga analiza e thjeshtë matematikore, mbështetur në dy treguesit kryesorë planifikimi/realizimi i fondeve. Gjithashtu, në këto vite Bashkia Berat nuk ka bërë të mundur financimin e këtij shërbimi nga fondet e veta.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e bërë nga bashkia, lidhur për mënyrën e menaxhimit dhe administrimit të qendrës, për tipologjinë e re të shërbimit të ngritur, por shpreh shqetësimin se ky shërbim nuk duhet të ndalojë vetëm me përgatitjen e personave me aftësi të kufizuar për jetesë të pavarur, por duhet të konkretizohet, duke patur rezultate të dukshme të përfituesve, të cilët jetojnë të pavarur. Zhvillimi i këtij shërbimi (jetesë e pavaruar) kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale si strehim, punësim, shërbime publike të tilla si: shëndetësia dhe ndërmarrjet sociale, të cilat menaxhohen dhe administrohen nga bashkia jashtë qendrës.

Në këtë kuptim, vazhdimësia e punës në ofrimin e shërbimeve integruese, është veprimtari, e cila do të ketë mbështetjen financiare edhe nga fondet e bashkisë, pasi në përputhje me nenin 24, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë kanë detyrimin ligjor të krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Gjithashtu, duke vlerësuar dhe numrin e madh të kërkesave të fëmijëve me aftësi të kufizuar, për të frekuentuar shërbimin ditor edhe nga zonat rurale të Bashkisë Berat, është e domosdoshme, që të planifikohet një fond i veçantë për transportin publik, për fëmijët dhe prindërit e tyre.

Qendra bashkëpunon edhe me shumë organizata të shoqërisë civile dhe fetare. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi bën të mundur organizimin e veprimtarive të ndryshme social-kulturore, okupacionale, etj.

Vlerësimi i ambienteve strukturore të Qendrës së Zhvillimit “Lira”, Berat

Qendra e Zhvillimit “Lira” ofron tipologjinë e shërbimit social - shëndetësor rezidencial dhe gjysmë rezidencial në përputhje me udhëzimin nr.1730, datë 27.9.2010, të ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të perkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore”.

Në vlerësim të projektit për ngritjen e kësaj qendre nga shoqata zvicerane “ASED”, infrastruktura e qendrës plotëson të gjitha kërkesat dhe normat arkitektonike, urbanistike, ndërtimore, parandalimin e zjarreve, higjienës, sigurisë, etj, të parashikuara në standardet minimale për të lehtësuar ofrimin e shërbimeve cilësore për personat me aftësi të kufizuar të vendosur në qendër, si dhe të punonjësve që janë të angazhuar për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Infrastruktura e qendrës është një ndërtesë një katëshe, e shtrirë në hapësirë dhe përfshin dy mjedise: dy apartamente të ndara, përkatësisht me nga 6-8 përfitues, e krijuar si një alternativë shërbimi për të mundësuar një jetë të pavarur, si dhe mjediset e përbashkëta, ku ofrohen shërbimet ditore dhe rezidenciale. Në këto mjedise gjenden:

- mjediset e përbashkëta për socializim;
- mjediset për atelie;
- laboratorë pune, fizioterapie, ku ofrohen shërbimet për kryerjen e programeve sipas disiplinave të ndryshme, të cilat janë të përshtatshme dhe plotësojnë nevojat për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme.

Ndërsa, në apartamente janë dhomat e gjumit, me dy deri në tre shtretër, me të gjitha paisjet e duhura të hotelerisë, si dhe mjediset ku ofrohet ushqimi (vaktet), shërbim catering. Përfituesit përfshiheshin në ndarjen dhe mbledhjen e ushqimit.

Sigurimi i sistemit të ngrohjes dhe freskimit në të gjithë mjediset e qendrës, në periudhën e verës dhe dimrit realizohet me kaldajë me naftë dhe ventilatorë. Në mjediset e qendrës ditore, ngrohja realizohet me kalorifer, pasi kaldajat nuk ishin funksionale. Tualetet janë të lidhura me dhomat, nëpërmjet koridoreve, ku dyert hapen nga jashtë, të përshtatshme për nevojat e PAK. Të gjitha tualetet janë të përshtatura me elementët përkatës, por vetëm dy tualete kanë elementë përbërës, sipas standardeve për personat me aftësi të kufizuara fizike.

Mjediset për lavanterinë, për rrobat e palara, garderobën, dhe rafte për vendosjen e rrobave të lara janë pjesë e atelieve, me të gjitha paisjet e duhura, ku atelia e hekurosjes është bërë shembull personal edhe nga stafi.

Vendodhja e qendrës është buzë lumit Osum dhe ky element ka ndikuar që në pjesën më të madhe të mureve të qendrës të evidentohet lagështira, e cila pavarësisht restaurimeve të herëpashershme, është e dukshme dhe shqetësuese për mirëqenien dhe zhvillimin e shëndetshëm të përfituesve.

Qendra ka furnizim të rregullt me ujë, elektricitet, si dhe plotëson kushtet higjeno-sanitare.

Nga bisedat e zhvilluara dhe vëzhgimet e kryera në institucion, u vërejt se siguria nga zjarri është element, i cili nuk plotëson standardet e sigurisë së jetës për përfituesit, pasi bombulat e fikseve të zjarrit ishin të pakoaluduara dhe stafi i qendrës i patrajnuar, për rastet e emergjencës, (p.sh., në rastet e rënies së zjarrit). Drejtuesi i qendrës informoi, se ka hartuar dy projekte për trajnimin e stafit me Policinë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH). Gjithashtu, për sa i përket masave të sigurisë së mjediseve të qendrës do të vendosen kamera, të cila janë donacione nga Raiffeisen Bank.

Po kështu, mbështetur edhe në shërbimin që qendra ofron, lidhur me mjediset e jashtme, u evidentua se ato nuk janë në përputhje me nevojat e përfituesve p.sh; fëmijët e qendrës ditore kanë nevojë për hapësira kreative në natyrë. Për këtë, qendra duhet të ketë hapësira të gjelbërta dhe kënde lojrash e sportive për përfituesit. Lidhur me këtë problematikë të evidentuar nga stafi i institucionit të Avokatit të Popullit, drejtuesi i institucioni na informoi, se është parashikuar në fondin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2019, ngritja e këndit të lojrave pranë qendrës.

Në përfundim, ajo që do të sugjerohet në kuadër të zbatimit të legjislacionit të ri të shërbimeve sociale, të udhëhequr nga plotësimi i nevojave apo minimizimi i ndikimit të pasojave negative të dukurive sociale tek fëmijët me aftësi të kufizuara, është ngritja, qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e punës për fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale për identifikimin, vlerësimin, përfshirjen dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës shtetërore.

Në këtë kuptim, institucioni i Avokatit të Popullit referuar parashtrimin të mësipërm, për çështjen në fjalë:

REKOMANDON:

- marrjen e masave për të kryer licensimin e qendrës, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi;
- marrjen e masave në vazhdimësi, për ofrimin e shërbimeve të integruara, për të mundësuar jetesë të pavaruar për përfituesit PAK kundrejt qasjes gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale si; në strehim, punësim, shërbime publike, etj;
- marrjen e masave, për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën me Zyrat Rajonale të Punësimit, për hartimin e programeve të veçanta, për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara;
- marrjen e masave, për qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e shërbimit të atelieve, si dhe hartimin e programeve për t'i kthyer ato në ndërmarrje sociale mbështetur në legjislacionin në fuqi;
- marrjen e masave nga Bashkia Berat, për ngritjen e këndit të lojrave pranë Qendrës së Zhvillimit “Lira”, si dhe parashikimit të fondit të veçantë për transportin publik, për të bërë të mundur frekuentimin e qendrës ditore nga fëmijët e zonave rurale të kësaj bashkie;
- marrjen e masave, për organizimin e veprimtarive promovuese, nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese gjithëpërfshirëse në mënyrë të vazhdueshme, që edhe shumë qytetarë të marrin shërbime nga atelietë e qendrës.
- marrjen e masave në mënyrë të vazhdueshme, për konsolidimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me strukturat e tjera, të cilat ofrojnë shërbime publike, për të mundësuar integrimin e përfituesve me diagnoza të lehta të shëndetit mendor në shkolla normale dhe kurse profesionale, me qëllim punësimin e tyre, për të realizuar jetesë të pavaruar, duke krijuar raporte të vazhdueshme dhe të rifreskueshme me shkollat, bizneset, profesionistë të lirë, etj;
- marrjen e masave, për promovimin e praktikave të mira të punës, ku rastet e suksesit të integrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë shembull pozitiv për komunitetin;
- marrjen e masave për të rritur numrin e kapacitetit të përfituesëve të shërbimit ditor në përputhje me nevojat e bashkisë Berat.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi e, në vijim të na informoni për qëndrimin Tuaj ndaj tij.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA